





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
GJYKATA KUSHTETUESE

# Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese

*Vendimet nëntor-dhjetor 2024*



Buletini periodik i vendimmarrjes  
Nr. 6 , nëntor-dhjetor 2024  
© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë





## HYRJJE

*Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ai ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.*

*Në këtë numër do të gjeni vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës nëntor–dhjetor 2024.*

## PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative .....	4
Ankim kushtetues individual (vendime përfundimtare) .....	7
Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve për ankimin kushtetues individual .....	17

**Parimi i sigurisë juridike, fuqia prapavepruese dhe pritshmëritë e ligjshme – Parimi i hierarkisë së normave**

## **FJALË KYÇE**

**Metodologji/ çmime mesatare të referencës/ pasuri e paluajtshme/ indeksim / vlerë e taksueshme**

**Çmimet mesatare të referencës janë të ndryshueshme dhe në rastin konkret kanë pësuar rritje, por transaksionet e mundshme të realizuara nga subjektet ndërtuese përpara miratimit të lejes së ndërtimit, pra dhe përpara hyrjes në fuqi të çmimeve të reja nuk përbëjnë të drejtë të fituar.**

**Çmimi i referencës është element përbërës i metodologjisë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme dhe taksave vendore.**

**Indeksimi i vlerës së taksës për ndërtimet e reja përkundrejt atyre ekzistues bëhet me qëllim diferencimin e këtyre dy kategorive dhe formulimi i këtij parashikimi ligjor është i qartë dhe i kuptueshëm. Indeksi e merr autorizimin drejtpërdrejt nga ligji për taksat vendore.**

## **Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (VKM për çmimet mesatare të referencës) - vendimi nr. 78, datë 06.11.2024**

### *Faktet*

Këshilli i Ministrave ka miratuar ndryshime në VKM-në për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, në aneksin I dhe II të saj. Sipas aneksit I kanë ndryshuar çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë ndërsa në aneksin II është parashikuar indeksimi i çmimit të sipërfaqes së apartamentit të banimit për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Parimi i sigurisë juridike* – Gjykata konstatoi se pretendimi i kërkueses në drejtim të fuqisë prapavepruese dhe të pritshmërive të ligjshme, në vetvete nuk ka të bëjë me çmimet mesatare të referencës të parashikuara nga VKM-ja objekt kundërshtimi, por me metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme dhe taksave vendore, të cilat kanë çmimin e referencës si element përbërës të metodologjisë së përlogaritjes së tyre. Për sa u takon pretendimeve për çmimin mesatar të referencës në vetvete, Gjykata evidentoi se ai përbën elementin bazë në planet e biznesit të vetë subjekteve ndërtuese, të cilat lidhin kontratat e shitblerjes së sipërfaqeve të banimit në momentin e pajisjes me lejen e ndërtimit. Në këtë kuptim transaksionet e mundshme të realizuara nga subjektet ndërtuese përpara miratimit të lejes së ndërtimit, pra dhe përpara hyrjes në fuqi të çmimeve të reja, të cilat (transaksionet) do të ndikohen nga ndryshimet e çmimit të referencës, nuk mund të përbëjnë të drejtë të fituar të tyre dhe, si të tilla, nuk mund të përfshihen në pritshmëritë e ligjshme të kërkueses.

Për sa i përket pretendimeve për indeksimin e çmimit të sipërfaqes së apartamentit të banimit për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK, Gjykata vlerësoi se formulimi i këtij parashikimi rezultoi i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk ka vend për konfuzion në lidhje me zbatimin e tij.

Po kështu, Gjykata vlerësoi se ligji për taksat ka autorizuar Këshillin e Ministrave për përcaktimin e metodologjisë së përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme dhe për rrjedhojë, parashikimi i indeksimit të çmimeve për banesat e reja përbën një detajim të këtij autorizimi ligjor. Për rrjedhojë, nuk është cenuar parimi i hierarkisë së normave, pasi ky parashikim është nxjerrë në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi njëzëri rrëzimin e kërkesës.

**E drejta e votës (e drejta për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur) e lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit**

### **FJALË KYÇE**

***Votë parapëlqyese/ listë shumëmemërore me renditje të fiksuar / kandidat / zgjedhje / Kodi Zgjedhor / interpretim i Kushtetutës / shpërndarje e mandateve***

**Parashikimi i lidhëzës “dhe” në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor e lidhur me nenin 163 të tij nuk cenon nenin 64 të Kushtetutës, pasi ky i fundit garanton në nivel kushtetues votimin parapëlqyese për jo më pak se dy të tretat e listës shumëmemërore, por jo shkallën e ndikimit të tij në shpërndarjen e mandateve. Në këtë kuptim, në thelb ajo që konkurren është partia politike, pavarësisht se votimit përveç partisë i nënshtrohen edhe kandidatët e saj në të dy komponentët e listës shumëmemërore. Ky parashikim nuk cenon as parimin e barazisë përpara ligjit ndërmjet partive politike, dispozitat e kundërshtuara nuk kanë përcaktuar kritere kufizuese për partitë e reja. Edhe përcaktimi i presjes dhjetore nuk cenon standardin e nenit 64 të Kushtetutës.**

**Partitë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, “Nisma Thurje”, “Aleanca Demokracia e Re”, “Lëvizja Demokratike për Ndryshim”, “Kombëtare Konservatore Albania”, “Bashkimi Demokristian Shqiptar” dhe “Ora e Shqipërisë”, organizata “Shqipëria bëhet”, Lulzim Basha, Orjola Pampuri, Merita Baku dhe Gëzim Ademaj (Kodi Zgjedhor) - vendimi nr. 85, datë 24.12.2024**

### **Faktet**

Në vitin 2020 Kuvendi ka miratuar disa ndryshime në nenet 64 dhe 68, pika 1, të Kushtetutës, të cilat parashikojnë sistemin zgjedhor proporcional me konkurrencë rajonal dhe prag kombëtar, si dhe të drejtën e zgjedhësve për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumëmemërore. Në bazë të këtyre dispozitave janë miratuar edhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor, mes të tjerash në nenet 67 dhe 163 të tij, që parashikojnë paraqitjen nga partia politike ose koalicioni zgjedhor të listës që përbëhet nga: a) lista shumëmemërore me renditje të fiksuar të kandidatëve; dhe b) lista shumëmemërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyese, ashtu edhe shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues të listës. Kërkuessit i drejtuan Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e tyre dhe interpretimin përfundimtar të nenit 64 të Kushtetutës ose shfuqizimin e tij.

### **Vlerësimi i Gjykatës**

#### **Juridiksioni**

Kontrolli i kushtetutshmërisë së dispozitave të Kodit Zgjedhor nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të nenit 64 të Kushtetutës, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes kushtetuese. Për sa i takon kërkimit për shfuqizimin e nenit 64 të Kushtetutës, ai del jashtë juridiksionit kushtetues, për sa kohë Gjykata nuk kontrollon kushtetutshmërinë e normave kushtetuese, por vetëm respektimin e procedurës në rast të shqyrtimit të një ligji rishikues të Kushtetutës.

#### **Legjitimitimi**

Partitë politike legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës për pretendimin për cenimin e së drejtës së votës në drejtim të së drejtës për t'u zgjedhur, ndërsa organizata dhe individët për të drejtën për të zgjedhur të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit.

*Për cenimin e së drejtës së votës (së drejtës për t'u zgjedhur dhe për të zgjedhur) të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit*

*Për partitë politike në lidhje me të drejtën për t'u zgjedhur*

*Për parashikimin e lidhëzës “dhe” në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij - Fillimisht Gjykata u ndal në interpretimin e nenit 64, i cili garanton që votimit parapëlqyese t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumëmemërore, pra të drejtën e zgjedhësve për të dhënë votë parapëlqyese për jo më pak se dy të tretat e kandidatëve, por jo shkallën e ndikimit të tij në shpërndarjen e mandateve, e cila është lënë në diskrecion të ligjvënësit nëpërmjet delegimit.*

Parashikimi i lidhëzës “dhe” në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, i lexuar së bashku me nenin 163 të tij, nënkupton se partitë politike si subjekte zgjedhore kanë detyrimin të përbushin kërkesat që disiplinonin procesin zgjedhor, ndër të tjera, atë për të paraqitur listën shumëmemërore me dy komponentë (atë me renditje të fiksuar dhe atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyese) që do t'i nënshtrohet procesit të votimit. Ndonëse subjektet kanë detyrimin për të paraqitur listën shumëmemërore të përbërë nga dy komponentë, vendosja e kandidatëve nga ana e partisë në komponentin me renditje të fiksuar ose në atë që i nënshtrohet votimit parapëlqyese nuk cenon në thelb të drejtën për t'u zgjedhur të kërkueseve dhe as pjesëmarrjen e tyre në procesin e formimit të vullnetit politik. Edhe pretendimi për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit nuk është i bazuar, pasi parashikimet ligjore nuk kanë përcaktuar kritere kufizuese për partitë e reja ose ato me elektorat më të vogël se partitë e tjera, të cilat u nënshtrohen të njëjtave rregullave për kandidim lidhur me përcaktimin e numrit të kandidatëve që paraqesin në KQZ.

*(vijon në faqen 6)*

**Lidhëza “dhe” në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor nuk pengon të drejtën e zgjedhësve për të shprehur opinionin e tyre dhe as parimin e barazisë përpara ligjit. Për të njëjtat shkaqe edhe presja dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor nuk cenon parashikimet e nenit 64 të Kushtetutës.**

*Për parashikimin e presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor—Edhe në lidhje me këtë parashikim pretendimet e kërkueseve lidhin me shpërndarjen e mandateve sipas rezultatit të votimit, gjë që Kushtetuta ia ka deleguar ligjvënësit. Për më tepër, numri i kandidatëve të komponentit të listës që i nënshtrohet votimit parapëlqyes është i barabartë me numrin e mandateve për çdo zonë zgjedhore, çka tejkalon parashikimin kushtetues prej dy të tretave të kandidatëve që marrin pjesë në votim.*

*Për organizatën dhe individët në lidhje me të drejtën për të zgjedhur*

*Për parashikimin e lidhëzës “dhe” në pikën 1 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor të lidhur me nenin 163 të tij—Gjykata vlerësoi se paraqitja në KQZ e dy komponentëve të listës shumë më të shumtë nuk kufizon të drejtën e shtetasve për të votuar, pasi ata mund ta ushtrojnë lirisht këtë të drejtë edhe për secilin nga kandidatët që ata preferojnë. Legjislacioni nuk ka vendosur asnjë ndalim dhe nuk ka përcaktuar kritere, të cilat duhet të përmbushen nga individët për të ushtruar të drejtën e votës, të garantuar nga neni 45 i Kushtetutës. Për sa i përket pretendimit të individëve për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit, parashikimet ligjore i drejtohen në mënyrë të njëjtë të gjithë zgjedhësve, duke garantuar mundësinë për të gjithë ata për të ushtruar të drejtën e votës pa dallime mbi bazë shtrese ose përkatësie në grupe të caktuara shoqërore ose mbi baza, kritere apo kategori të tjera, që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike.*

*Për parashikimin e presjes dhjetore në pikën 2 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor -Ky parashikim nuk cenon nenin 64, pika 3, fjalia e parë, të Kushtetutës, që parashikon të drejtën e zgjedhësve për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumë më të shumta, por pretendimet lidhen me shpërndarjen e mandateve sipas rezultatit të votimit, çka nuk është garantuar në nivel kushtetues.*

*Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).





**E drejta për t'u dëgjuar - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

## **FJALË KYÇE**

**marrëdhënie pune/ largim nga shërbimi civil / diskriminim për shkak të largimit nga puna pa shkak**

**Pasqyrimi në vendimin e Gjykatës së Lartë i shkaqeve të rekursit dhe shtesës së tij përbën element të rëndësishëm të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi u tregon palëve se janë dëgjuar dhe çështja e tyre është vlerësuar nga kjo gjykatë.**

## **Sose Buçpapaj (largim nga puna) - vendimi nr. 77, datë 05.11.2024**

### *Faktet*

Kërkuesja është larguar nga puna bazuar në ankesën e disa operatorëve ekonomikë ndaj saj. Ajo ka kundërshtuar masën e largimit fillimisht përmes procesit administrativ dhe më pas në rrugë gjyqësore, duke pretenduar cenimin gjatë procesit administrativ të së drejtës për t'u dëgjuar. Gjykatat e faktit kanë vendosur rrezimin e kërkesëpadisë së saj, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

Pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar janë të pabazuara, pasi gjatë procesit administrativ kërkueses i është dhënë mundësia për t'u njohur me faktet që e kanë ngarkuar me përgjegjësi administrative, si dhe të paraqesë argumente e prova në mbështetje të pretendimeve të saj, në garantim të së drejtës për t'u dëgjuar përgjatë këtij procesi. Po kështu, pretendimet në lidhje me këtë proces janë parashtruar nga kërkuesja edhe gjatë procesit gjyqësor. Gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar në prani të kërkueses dhe mbrojtësit të saj, ndërsa gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë janë vënë në lëvizje përmes ankimit dhe rekursit të kërkueses. Gjykatat e zakonshme kanë analizuar dhe vlerësuar pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar përkundrejt parashikimeve të ligjit material e procedural, duke arsyetuar qëndrimet e tyre.

Pretendimet për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara, pasi pasqyrimi në vendim i shkaqeve të rekursit dhe shtesës së tij përbën element të rëndësishëm të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Ai u tregon palëve se janë dëgjuar dhe çështja e tyre është vlerësuar nga Gjykata e Lartë.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice).

**Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor - Parimi i prezumimit të pafajësisë – E drejta e pronës private**

**FJALË KYÇE**

*Sekuestro preventive/ kontratë qiraje/ dhënie me koncesion/ port turistik/ partneritet publik privat/ funksionar publik/ pasuri shtetërore/ siguri kombëtare/ Plani i Vendosjes dhe i Përhapjes*

**Në shqyrtimin e kërkesës sipas kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, Gjykata nuk arriti shumicën e votave për vendimmarrje.**

**Sipas njërit qëndrim, masa e sekuestros nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë pasi midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti.**

**Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, masa e sekuestros e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi kërkueses i është vendosur një barrë e tepruar.**

**Shoqëria “Marina Bay Saranda” sh.p.k. (vendimet gjyqësore për vendosjen e masës së sekuestros të pasurisë së paluajtshme) - vendimi nr. 79, datë 12.11.2024**

*Faktet*

Prokuroria e Posaçme, mbi bazën e një kallëzimi penal, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Objekti i hetimit, fillimisht, është drejtuar në lidhje me veprimet a mosveprimet e funksionarëve publikë, të dyshuara si në kundërshtim me ligjin dhe përmbushjen e rregullt të detyrës, për sa i përket dhënies me qira të pasurisë nr. 696 me emërtimin “Baza Ndihmuese” Limion, Sarandë, e cila është në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe pjesë e Planit të Vendosjes dhe të Përhapjes. Më pas, objekti i hetimit është shtrirë edhe në lidhje me veprimet a mosveprimet e funksionarëve publikë për sa i përket dhënies me koncesion/ partneritet publik privat të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, Sarandë, pjesë e të cilit është edhe pasuria e lart përmendur, në favor të kërkueses. GJKKO e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, vendim ky që u la në fuqi nga GJKKO e Apelit. Kërkuësja ushtroi rekurs në Gjykatën e Lartë e cila vendosi mospranimin e tij. Kërkuësja iu drejtua me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, prezumimin e pafajësisë dhe cenimin e së drejtës së pronës private. Gjykata, duke pasur parasysh se, në thelb, pretendimet e kërkueses lidheshin me të drejtën e pronës, si një e drejtë që nuk mund të rikuperohet gjatë procesit të themelit të çështjes, si dhe duke mbajtur parasysh edhe pretendimet në drejtim të procesit të rregullt në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për të cilat u pretendua se kanë cenuar të drejtën substanciale të pronës, si dhe pretendimet e prezumimit të pafajësisë, që në thelb lidhen me arsyetimin e vendimeve, vlerësoi ta shqyrtojë çështjen në vijim në drejtim të kësaj të drejte, ndërkohë që aspektet që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, do t'i trajtojë si aspekte procedurale të së drejtës së pronës së garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

*Vlerësimi i Gjykatës*

*Për cenimin e së drejtës së pronës* - Për sa i përket ndërhyrjes që vendimi i sekuestrimit bën tek e drejta e pronës, Gjykata vlerësoi se ndërhyrja është bërë me ligj dhe se marrja e sekuestros i përgjigjet interesit publik edhe në drejtim të mbrojtjes së sigurisë kombëtare të lidhur me gatishmërinë dhe operacionalitetin e FD-së, në kushtet kur prona në fjalë është pjesë e PVP-së së pronave të KFD-së.

Për sa i takon kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, pra që marrëdhënia midis sekuestros dhe qëllimit të ndjekur të jetë e arsyeshme, Gjykata vlerësoi se lidhur me nevojën e ndërhyrjes, duke qenë se në rastin konkret kjo është një pasuri publike dhe disponimi i lirë i pronës mund të ndikojë në shtimin e rrezikut mbi gatishmërinë dhe operacionalitetin e KFD-së, duke vënë në rrezik vazhdues interesat kombëtarë të sigurisë së Republikës së Shqipërisë, vendosja e masës së sekuestros preventive është e nevojshme, pasi është e aftë të pengojë cenimin e interesave kombëtarë të shtetit shqiptar deri në përfundimin e procesit penal në ngarkim të disa funksionarëve në kuadër të të cilit është marrë kjo masë.

Lidhur me përshtatshmërinë e masës, ajo është e përshtatshme dhe jo përtej asaj që është e pashmangshme pasi gjykatat kanë arsyetuar në drejtim të këtij kriteri se arsyeshmëria e masës është e lidhur me paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga disa funksionarë shtetërorë gjatë procedurës për dhënie me qira të pasurisë nr. 696, në përfundim të së cilës është lidhur dhe miratuar kontrata e qirasë mes kërkueses dhe MFE-së, veprime që janë konsideruar se përbëjnë elemente të veprës penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së, ashtu edhe se interesi publik i mbrojtjes kombëtare prevalon në këtë rast mbi interesat individuale.

Lidhur me ashpërsinë e masës së sekuestros, qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë. Sipas njërit qëndrim, masa e sekuestros nuk tejkalon kriterin e ashpërsisë pasi midis vendimit të sekuestros dhe qëllimit të ndjekur duket se ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti, prandaj kufizimi i së drejtës së kërkueses është në raport të drejtë me gjendjen që e ka diktuar atë. Sipas qëndrimit tjetër, masa e sekuestros e tejkalon kriterin e ashpërsisë, pasi kërkueses i është vendosur një barrë e tepruar, për sa kohë që veprimtaria e saj rezulton të jetë bazuar në procedura ligjore dhe akte nënligjore të miratuara nga autoritetet publike, çka ka bërë që për kërkuesen të lindin pritshmëri të ligjshme në drejtim të gëzimit të të drejtave dhe interesave që burojnë nga kjo marrëdhënie kontraktore dhe që lidhen me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në fjalë.

*Vendimmarrja*

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh të kërkuar nga neni 133, pika 2, i Kushtetutës.



**E drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj - E drejta për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm – Konstatimi i cenimit të afatit dhe përshpejtimi i procedurave - E drejta për rehabilitim dhe/ose zhdëmtim**

## **FJALË KYÇE**

**Afat i arsyeshëm/ shkelje e afatit të arsyeshëm/ tejzgjatje e paarsyeshme e afatit**

**Në shqyrtimin e kërkesës sipas kriterëve që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme të procesit gjyqësor, në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkesja, Gjykata nuk arriti shumicën e votave për vendimmarrje.**

**Sipas njërit qëndrim, tejzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka bërë që pretendimet e kërkuases, edhe nëse njihen gjyqësisht, të mbeten pa vlerë.**

**Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, nuk ka rezultuar që kërkesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur.**

## **Shoqëria “Zyra e Përmbarrimit Privat ARB” sh.p.k. (cenimi i së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm për shkak të tejzgjatjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë) - vendimi nr. 80, datë 21.11.2024**

### *Faktet*

Kërkesja ka lidhur një kontratë shërbimi për ekzekutimin e një urdhri ekzekutimi. Duke pretenduar se një bankë e nivelit të dytë nuk ka përmbytur urdhërimet e saj për debitimin e llogarisë së debitorit në atë bankë, me qëllim pengimin e zbatimit të ekzekutimit, kërkesja në vitin 2014, i është drejtuar gjykatës me padi për shpërbllimin e dëmit pasuror e jopasuror të pësuar nga mosveprimet e bankës, për fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore përkatëse. Padia e saj është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim që u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Kërkesja ushtroi rekurs në Gjykatën e Lartë dhe meqenëse rekursi nuk po shqyrtohej, ajo i është drejtuar asaj gjykate me kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit. Duke pretenduar se Gjykata e Lartë ishte në vonesë si për shqyrtimin e çështjes civile, ashtu edhe për shqyrtimin e kërkesës së saj për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, kërkesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), e cila e rrëzoi kërkesën e saj. Pas atij vendimi edhe Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të paraqitur nga kërkesja. Me qëllim shfuqizimit e këtij vendimi të fundit, kërkesja i është drejtuar sërish Gjykatës, Mbledhja e Gjyqtarëve të së cilës, vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Më pas, kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një kërkesë të re për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Ndërkohë që kërkesa ishte duke u shqyrtuar nga ajo gjykatë, kërkesja i është drejtuar për herë të tretë Gjykatës.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm* - Kërkesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka tejkaluar ndjeshëm afatin e arsyeshëm në gjykimin e çështjes së saj, pasi rekursi ishte regjistruar në vitin 2016 dhe nuk ishte gjykuar ende. Prej kësaj tejzgjatjeje, interesi ekonomik i kërkuases dhe personal-vejtak, si dhe psikosocial e shëndetësor i ortakut të vetëm të saj, rrezikohen në një shkallë të konsiderueshme, duke qenë se masa e sigurimit personal të arrestit në shtëpi e vendosur ndaj ortakut të saj po e çon kërkuesen drejt falimentimit.

Gjykata analizoi rrethanat e veçanta të çështjes në lidhje me kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuases; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesja.

Në lidhje me sjelljen e kërkuases, ajo nuk rezultoi të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes. Për sa i takon kompleksitetin e çështjes, ai nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Në rastin konkret, gjykimi në gjykatën e ligjit është vlerësuar se nuk paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit.

Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuases lidhet me ngarkesën e shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Përtej kësaj, Gjykata ka vlerësuar se së fundmi në kohëzgjatjen e afatit kanë ndikuar edhe aspektet procedurale për shqyrtimin e çështjes civile të kërkuases.

Në drejtim të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkesja, qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë.

Sipas njërit qëndrim, tejzgjatja e gjykimit në Gjykatën e Lartë ka bërë që pretendimet e kërkuases, edhe nëse njihen gjyqësisht, të mbeten pa vlerë.

Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, nuk ka rezultuar që kërkesja të ketë pësuar dëm pasuror nga veprimet e palës së paditur. Në këtë kuptim, edhe pse ka një tejzgjatje të procesit, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuases, numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë në pritje për t'u gjykuar, si dhe faktin se ajo gjykatë ka ndërmarrë veprime konkrete për vënien në lëvizje të procesit civil të kërkuases, nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh të kërkuar nga neni 133, pika 2, i Kushtetutës.

**Cenimi i të drejtës për t'u zgjedhur dhe lirisë së lëvizjes - Cenimi i parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë si rezultat i rregullimeve ligjore – E drejta për mbrojtje efektive – Standardi i arsyetimit si aspekte procedurale të drejtave substanciale të sipërpërmendura – Parimi i proporcionalitetit në caktimin e masave të sigurimit të vendosura mbi kërkuesin**

## **FJALË KYÇE**

**Deputet/ kryeministër/ liri personale/ liri e lëvizjes/ autorizim nga Kuvendi/ mbrojtje efektive/ proporcionalitet/ e drejta për t'u zgjedhur/ ushtrim i mandatit parlamentar/ masa sigurimi/ vëzhgim telekomunikacioni/ detyrim paraqitjeje/ ndalim i daljes jashtë shtetit**

**Autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t'u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare.**

## **Sali Berisha (kundërshtimi i vendimeve gjyqësore që kanë vendosur masat e sigurimit ndaj deputetit – dhënia e autorizimit nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2 të Kushtetutës) - vendimi nr. 81, datë 21.11.2024**

### *Faktet*

Kërkuesi, politikan, ish-president dhe ish-kryeministër, aktualisht deputet i Kuvendit dhe kryetar i partisë kryesore opozitare, është akuzuar nga Prokuroria e Posaçme si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së, për kohën kur ka ushtruar funksionin e kryeministrit. Për këtë arsye, mbi kërkesën e organit të akuzës, gjykatat e zakonshme kanë caktuar ndaj tij dy masa sigurimi, konkretisht “Detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimin e daljes jashtë shtetit”. Sipas gjykatave të të tria shkallëve, për caktimin e këtyre masave të sigurimit nuk nevojitet autorizimi i Kuvendit sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, pasi nevojitet vetëm në rastet e caktimit të masave të sigurimit personal që kufizojnë lirinë e personit, konkretisht për masat e arrestit në shtëpi/burg.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Për cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur dhe të lirisë së lëvizjes (Aspekti procedural)*

*Për autorizimin nga Kuvendi sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës*

Sipas Gjykatës togfjalëshi “ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme”, i parashikuar në nenin 73, pika 2 të Kushtetutës, i referohet vetëm lirisë personale, të mbrojtur nga neni 27 i Kushtetutës dhe ai gjen zbatim vetëm në ato raste kur ndaj deputetit vendoset një masë kufizuese, që i heq lirinë personale. Për pasojë, autorizimi i Kuvendit është i nevojshëm vetëm nëse masat kufizuese të vendosura ndaj kërkuesit përbëjnë kufizim/heqje të lirisë së tij personale, i cili është i tillë që sjell pasoja në vetë të drejtën e deputetit për t'u zgjedhur, në aspektin e ushtrimit të të drejtave të tij si deputet, pra të vetë veprimtarisë parlamentare. Gjykata vlerësoi se masa e sigurimit “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, në këndvështrim të së drejtës për t'u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshtësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek funksionet legjislativ të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrorë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, Gjykata vlerësoi se edhe masa e sigurimit e ndalimit për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvillojë jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit.

*Për cenimin e parimit të paanshmërisë për shkak të dispozitave të ligjit nr. 95/2016*

Gjykata vlerësoi se ligji nr. 95/2016 përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve të gjykatave të posaçme lidhur me mënyrën se si realizohet vëzhgimi i telekomunikimeve të tyre vetjake. Sipas Gjykatës kuadri ligjor në fuqi që rregullon statusin e magistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shtesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e këtyre gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit të tyre, ku përfshihet sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimin ashtu edhe trajtimin e posaçëm të tyre.

*Për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive*

Gjykata vlerësoi se nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë janë marrë të gjitha masat për njoftimin kërkuesit të vendimit, i cili ka disponuar për masat e sigurimit personal të vendosura ndaj tij. Gjithashtu, nga faktet e parashtruara, të evidentuara nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Gjykata evidentoi se kërkuesit i është dhënë koha e nevojshme për të realizuar mbrojtjen në raport me volumin e akteve dhe afatin 5-ditor brenda të cilit, sipas parashikimeve të KPP-së, duhej të përfundonte gjykimi. Në lidhje me vonesën në arsyetimin e vendimit për vazhdimin e masave të sigurimit, Gjykata vlerësoi se kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja mbi të drejtën e kërkuesit për mbrojtje efektive, për sa kohë ai ka ushtruar normalisht të drejtat procedurale të ankimit dhe rekursit në përgjigje të të cilave GJKKO-ja e Apelit dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë kanë disponuar me vendimet përkatese.

*(vijon në faqen 11)*

**Masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, në këndvështrim të së drejtës për t’u zgjedhur, sipas nenit 45 të Kushtetutës, duke iu referuar llojit të detyrimit dhe shpeshësisë së zbatimit të saj (në rastin konkret një herë në dy javë), nuk prek funksionet legjislative të Kuvendit dhe nuk e pengon kërkuesin të ushtrorë të drejtat e tij si deputet. Mbi të njëjtin argument, edhe masa e sigurimit e ndalimit për të dalë jashtë shtetit nuk e pengon kërkuesin të zhvillojë jetën e tij parlamentare. Për rrjedhojë, për sa kohë që kjo masë nuk përbën kufizim të lirisë personale pika 2 e nenit 73 të Kushtetutës nuk kërkon autorizimin e Kuvendit për zbatimin e saj ndaj deputetit.**

Po ashtu, Gjykata referuar veprimeve të kërkuesit, që ka zgjedhur të mos marrë pjesë në këtë seancë, ashtu edhe veprimeve të mbrojtësve të tij, që kanë kërkuar kohë nga gjykata dhe në vijim janë larguar nga salla, vlerësoi se ato, në dukje, duket se janë një zgjedhje e vullnetshme e kërkuesit dhe, për këtë shkak, ai (kërkuesi) duhej të ishte në gjendje të parashikonte zëvendësimin e mbrojtësve të zgjedhur me një avokat të caktuar kryesisht nga lista e avokatëve. Në përfundim, Gjykata vlerësoi se kërkuesi e ka ushtruar lirisht të drejtën e mbrojtjes në të gjitha shkallët e gjykimin, nëpërmjet mbrojtësve të caktuar kryesisht në shkallën e parë, nëpërmjet paraqitjes së ankimit dhe rekursit nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij dhe pjesëmarrjes së tyre në gjykim (në rastin e gjykimin në gjykatën e apelit).

### *Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit*

Për sa i përket arsytimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse në atë vendim janë përdorur terma teknikë që vështirësojnë në pamje të parë kuptimin e vendimit, përdorimi i tyre nuk është në atë nivel që të cenojë standardin e arsytimit nga pikëpamja e qartësisë. Për më tepër që në Gjykatën e Lartë, në përputhje me parashikimet ligjore, kërkuesi ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për të kuptuar termat teknikë të përdorur në vendim.

### *Për aspektin substancial*

Referuar arsytimit dhe interpretimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave, Gjykata konstatoi se atyre (gjykatat e juridiksionit të zakonshëm - GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit) u mungon arsytimi, për rrjedhojë nuk rezultoi të kenë vlerësuar nevojën për caktimin e dy masave të sigurimit personal për të njëjtin procedim ndaj kërkuesit. Gjykata theksoi se kjo mungesë arsytimi, interpretimi dhe vlerësimi, ngre dyshime nëse ato e kanë vlerësuar kriterin e proporcionalitetit të masave në drejtim të nevojës për kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe së drejtës për t’u zgjedhur në drejtim të kërkuesit, në funksionin e deputetit, sipas neneve 228 e vijues të KPP-së, në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe lirive të kërkuesit, në raport mbarëvajtjen e procedimit penal, çka është e detyrueshme sipas Kushtetutës dhe KPP-së, Gjykata vlerësoi se kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po kështu, Gjykata, mbi bazën e të njëjtave argumente, konstatoi se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” duket se i plotësonte nevojat e sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në këtë kuptim, Gjykata çmoi se, në mungesë të arsytimit të nevojës për caktimin e dy masave të sigurimit, si dhe të faktit që qëllimi legjitim i mbarëvajtjes së procedimit penal përmbushet nga masa e sigurimit të detyrimit për paraqitje, arriti në përfundimin se ka cenim të parimit të proporcionalitetit nga caktimi i masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”.

Në vlerësimin e Gjykatës, mungesa e arsytimit të nevojës në përcaktimin e dy masave tregon ndër të tjera, mosvlerësimin e këtij aspekti kushtetues dhe ligjor nga ana e gjykatave të zakonshme në caktimin e masave të sigurimit personal. Për rrjedhojë, caktimi i kësaj mase të fundit ka cenuar, në aspektin substancial, të drejtën për t’u zgjedhur dhe lirinë e lëvizjes

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e pjesëshëm të kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër dhe një gjyqtar me mendim pjesërisht kundër).

**E drejta e aksesit- E drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj- Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit- Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

### **FJALË KYÇE**

*Sigurim i detyrueshëm në sektorin e transportit/ zbatimi i ligjit material nr. 10076/2009, zbatimi me fuqi retroaktive i rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, vendimi unifikues nr.12/2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

**Kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsytimit në vendimin e Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime.**

### **Ardian Hysa etj (për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit) - vendimi nr. 82, datë 26.11.2024**

#### *Faktet*

Kërkuesit janë familjarë të një shtetasi që ka humbur jetën në aksident rrugor si dhe shtetas të dëmtuar nga aksidenti e familjarë të tyre, të cilët kanë kërkuar shpërblim të dëmit pasuror e jopasuror ndaj shoqërisë së sigurimit të mjetit që ka shkaktuar aksidentin.

Duke pretenduar dëmshpërblim për ngjarjen aksidentale, kërkuesit i janë drejtuar gjykatës me padi për dhënien e dëmshpërblimeve respektive sipas përcaktimeve të ligjit nr.10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Padia e tyre u pranua pjesërisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim që u ndryshua nga Gjykata e Apelit Tiranë, kurse Gjykata e Lartë vendosi mospranimin e rekursit të kërkuesve.

#### *Vlerësimi i Gjykatës*

Gjykata ka vlerësuar se, referuar natyrës kushtetuese të pretendimeve të parashtruara në recurs, Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Në këto kushte, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsytimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, të çon në përfundimin se zbatimi i ligjit procedural nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e aksesit të kërkuesve në drejtim të së drejtës për ankim efektiv në një gjykatë më të lartë. . Për pasojë, është cenuar e drejta e aksesit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

#### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).



**Caktim masash sigurimi personal në kuadër të hetimit penal – Aspektet procedurale dhe substanciale të lirisë personale – E drejta për jetë private – Liria e korrespondencës**

## **FJALË KYÇE**

**Procedim penal/ dyshim i arsyeshëm/ kufizim i lirisë personale/ proporcionalitet/ barazi përpara ligjit / mosdeklarim fajtor për një veprë penale që nuk konsiderohet e tillë me ligj/ e drejta për jetë private**

**Aspekti substancial i lirisë personale analizohet nën dritën e nenit 27 të Kushtetutës, ndërsa aspekti procedural i saj nën atë të nenit 28 të lidhur me nenin 42 të Kushtetutës.**

## **Jamarbër Malltezi (kufizim i lirisë personale)- vendimi nr. 83, datë 05.12.2024**

### *Faktet*

Kërkuesi është hetuar penalisht për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 260 në bashkëpunim dhe 287 të KP-së. Në kuadër të këtij procesi ndaj tij është caktuar fillimisht masa e sigurimit personal “Arresti në burg”, e miratuar më pas me vendim gjykate. Kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht vendimet për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës. Gjykata e apelit ka vendosur ndryshimin e masës së caktuar në masën “Arresti në shtëpi”, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

#### *Aspekti procedural i lirisë personale.*

E drejta për t’u dëgjuar nuk cenohet si rrjedhojë e vendimmarrjes së gjykatës për caktimin e masës në dhomë këshillimi, pasi neni 244 i KPP-së parashikon këtë lloj gjykimi dhe kërkuesi ka marrë përgjigje për këtë pretendim nga gjykatat e zakonshme.

Ligjvënësi ka parashikuar afate të shpejta kohore për shqyrtimin nga gjykatat të masave të sigurimit. Mënyra se si mbrojtësit zgjedhin të realizojnë mbrojtjen mbetet çështje mes tyre e kërkuesit dhe i përket strategjisë së mbrojtjes. Pretendimi për cenimin e së drejtës për mbrojtje efektive, si rrjedhojë e mosdhënies së kohës së nevojshme për realizimin e mbrojtjes, është i pabazuar, pasi gjykata i ka dhënë kohë kërkuesit për përgatitjen e mbrojtjes, duke shtyrë seancën me disa orë. Për më tepër, e drejta për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore i ka lindur kërkuesit që në momentin e njoftimit të vendimit të masës së arrestit, dhe që nga ky moment i kanë lindur të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara nga neni 34/b i KPP-së, për të cilat ka marrë dijeni.

Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor nuk është cenuar, pasi vendimet nuk rezultojnë të jenë alogjike, të kenë kundërthënie, të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojnë elementet e trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese. Termet teknikë të përdorur në vendim nga Gjykata e Lartë, edhe pse vështirësojnë në pamje të parë kuptimin e vendimit, nuk shfaqin problematika qartësie për mbrojtësit ligjorë, të cilët kanë kualifikimin e nevojshëm për t’i kuptuar ato.

#### *Aspekti substancial i lirisë personale*

Pretendimet për mungesën e ekzistencës së dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale janë të pabazuara, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë treguar kujdes në analizën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova për ekzistencën e një *pactum sceleris* mes tij dhe babait të bashkëshortes, ish-Kryeministër i vendit, duke arsyetuar në vendimmarrjet e tyre për faktet, informacionet, si dhe provat e marra në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat kanë krijuar bindjen se mes kërkuesit dhe veprave penale për të cilat dyshohet ekziston një lidhje objektive, që përligj ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në prova, si kusht *sine qua non* për kufizimin e lirisë personale.

Për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të proporcionalitetit, si rrjedhojë e caktimit të masës “Arresti në shtëpi” dhe së të drejtës për jetë private Gjykata nuk arriti kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.

Sipas njërit qëndrim, masa e sigurimit është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit e rëndësinë e faktit penal për të cilin ai dyshohet dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale, ndërsa mban në konsideratë edhe treguesit personalë të kërkuesit.

*(vijon në faqen 14)*

**Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale.**

**Për të vlerësuar nëse përmbushet kushti për ekzistencën e dyshimeve të arsyeshme për kufizimin e lirisë personale të kërkuesit, Gjykata analizon nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore ka qenë ose jo arbitrar në këndvështrimin kushtetues.**

Sipas qëndrimit tjetër, gjykatat e zakonshme nuk kanë arritur të arsyetojnë në masën dhe nivelin që kërkon ndërhyrja në të drejtat dhe liritë kushtetuese, në mënyrë që ajo të konsiderohet proporcionale dhe në lidhje me këtë, të arsyetonin edhe pse ishte e përshtatshme. Po ashtu nuk kanë analizuar nëse një masë tjetër me natyrë personale apo edhe një qëndrim i ndryshëm në lidhje me kërkesën e prokurorisë nuk do të ishte në gjendje të siguronte mbarëvajtjen e procedimit penal apo do ta vinte në rrezik atë.

*Për të drejtën për jetë private* - Gjykata analizoi nëse kërkuesi ka pasur mundësinë të krijojë hapësirën e nevojshme për të zhvilluar personalitetin e tij, si dhe për të ushtruar lirisht lirinë e korrespondencës dhe të komunikimit, duke u ndalur edhe në përmbajtjen e nenit 237 të KPP-së, para dhe pas ndryshimeve.

Gjykata, pasi mori në shqyrtim këtë pretendim, nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje.

Sipas njërit qëndrim, nuk ka cenim të së drejtës për jetë private dhe vendosja e kufizimit ose ndalimit të të pandehurit për të komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë me të, përbën vetëm një mënyrë për ekzekutimin e masës së sigurimit dhe nuk është në vetvete një masë e mëvetësishme siguri.

Sipas qëndrimit tjetër, vendosja nga gjykata e ndalimit për kërkuesin për të mos komunikuar me persona të tjerë, me përjashtim të atyre që banojnë në të njëjtën banesë me të, përbën një kufizim të ri, shtesë, të të drejtave të tij kushtetuese, konkretisht asaj për jetë private, ndërkohë që kjo nuk konsiderohet si një masë që synon ekzekutimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi rrëzimin e kërkesës (njëzëri për disa pretendime të kërkuesit, ndërsa për disa të tjera sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh të kërkuar nga neni 133, pika 2, i Kushtetutës).





## Liria personale në aspektin procedural dhe substancial

### FJALË KYÇE

**Komunikime elektronike/ përgjime/ aplikacioni Sky ECC/ letërporosi/ përgjim masiv/ dyshim i arsyeshëm për kufizimin e lirisë/ proporcionalitet i masës/ garanci pasurore**

**Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për liri personale, si në aspektin procedural, as në atë formal. Kërkuari ka pasur mundësi të njihet me aktet e dosjes, ka ushtruar lirisht të drejtën e ankimit si dhe ka pasur kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes. Dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masës së sigurimit arresti në burg bazohet jo vetëm në komunikimet elektronike në aplikacionin Sky ECC, por edhe në prova të tjera. Gjatë gjykimit në themel, kërkuari ka të gjitha mundësitë për të kundërshtuar vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e provave, përfshi edhe komunikimet elektronike.**

## Pëllumb Gjoka (cenimi i lirisë personale) - vendimi nr. 86, datë 30.12.2024

### Faktet

Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për kryerjen e disa veprave penale në emër të kërkuarit. Pas administrimit të disa provave të përcjella me letërporosi nga autoritetet e drejtësisë franceze (komunikime në aplikacionin Sky ECC) prokuroria ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”. GjKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur caktimin e kësaj mase me arsyetimin se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se kërkuari ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet dhe krahas të dhënave të hetimit, një rol të rëndësishëm kanë pasur edhe të dhënat e marra nga komunikimet me aplikacionin Sky ECC. Ky vendim është lënë në fuqi nga GjKKO-ja e Apelit, ndërsa në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Kërkuari iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual fillimisht për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore dhe në vijim ka paraqitur kërkesë edhe për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

### Vlerësimi i Gjykatës

**Legjitimiti** - Gjykata vlerësoi se pretendimet për shfuqizimin e dispozitave ligjore janë, në thelb, të njëjta me ato të shqyrtuara më parë prej saj, ndaj çmoi se ndodhet përpara gjësë së gjykuar.

Kushtetuta lejon shprehimisht kufizimin e lirisë personale për shkak të interesit publik që lidhet me mbarëvajtjen e procedimit penal dhe dhënien e drejtësisë. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm jo vetëm justifikon në nivel kushtetues kufizimin e lirisë personale, por nuk rrezikon as parimin e prezumimit të pafajësisë në këtë fazë të procedimit penal. Për më tepër, dyshimi i arsyeshëm është shkaku për të cilin caktohet masa e heqjes së lirisë në një procedurë gjyqësore që garanton elemente thelbësore të procesit të rregullt. Për rrjedhojë, analiza e Gjykatës fokusohet në verifikimin e dyshimit të arsyeshëm në kufizimin e lirisë personale të kërkuarit.

### Për themelin

- **Për cenimin e lirisë personale në aspektin procedural** – Gjykata u ndal në analizën e pretendimeve për cenimin e të drejtës së mbrojtjes të lidhur me të drejtën e njohjes me dokumentacionin e dosjes gjyqësore dhe të drejtën e ankimit efektiv, për të cilin vlerësoi se megjithëse përfaqësuesit e kërkuarit nuk ishin lejuar të mbanin shënime në lidhje me aktet e dosjes, kjo shkelje nuk ka cenuar vetë thelbin e së drejtës për t’u mbrojtur në këtë fazë të procedurës, për sa kohë që kërkuari ka ushtruar të drejtën e ankimit. Në drejtim të kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes Gjykata vlerësoi se përfaqësuesit e kërkuarit nuk rezultojnë të jenë vënë në pamundësi për të përgatitur mbrojtjen e tij, pasi janë marrë të gjitha masat për të siguruar njohjen me aktet e dosjes. Edhe për sa i përket pretendimit për të drejtën e ankimit efektiv në gjykatë Gjykata vlerësoi se kërkuari e ka ushtruar këtë të drejtë jo vetëm në aspektin formal, por edhe substancial.

**Për të drejtën për t’u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit** Gjykata vlerësoi se kërkuari i është garantuar e drejta për të kundërshtuar pretendimet e organit të akuzës për sa i përket ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për pjesëmarrjen e tij në kryerjen e veprave penale që kanë justifikuar kufizimin e lirisë personale.

### - Për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial

#### Për dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova

Gjykata fillimisht evidentoi se për provat mbi të cilat mbështetet masa e sigurimit personal nuk kërkohet që të jenë në të njëjtin nivel provueshmërie me ato mbi të cilat bazohet vendimi i themelit që ka të bëjë me (pa)fajësinë e të pandehurit. Komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC janë përcjellë nga autoritetet franceze në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë mes autoriteteve të të dyja vendeve. Në drejtim të krijimit të dyshimit të arsyeshëm ai nuk rezultoi të jetë bazuar vetëm në komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC, por edhe mbi të dhëna të tjera të përfuara gjatë veprimtarisë hetimore apo të marra nga procedime të tjera penale. Gjykata vlerësoi se në gjykimin në themel, kërkuari ka mundësinë dhe të drejtën që të kundërshtojë, në drejtim të ligjshmërisë dhe përdorshmërisë së tyre, edhe komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC dhe u takon gjykatave të zakonshme të vlerësojnë aspekte të (pa) vlefshmërisë dhe (pa)përdorshmërisë së provave.

Për sa i përket të drejtës për t’u proceduar në liri kundrejt garancisë pasurore Gjykata vlerësoi se masa e sigurimit personal “Arresti në burg” është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit e rëndësishëm e faktit penal për të cilin ai dyshohet dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale.

### Vendim marrja

Gjykata vendosi njëzëri rrezimin e kërkesës.



# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Liria personale, dinjiteti dhe siguria — E drejta për privatësi të korrespondencës — E drejta e pronës — Të drejtat për ushtrimin e profesionit dhe arsimimit — E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.**

## **FJALË KYÇE**

**Heqja e sekuestros/sende të luajtshme/përdorim vetjak dhe familjar/sende të palidhura me veprat penale/korrupsion pasiv/pastrimi i produkteve të veprës penale/vlerë provuese/ndërhyrje në të drejta**

**Vendimet gjyqësore për mospranimin e kthimit të sendeve të luajtshme të sekuestruara kanë ndërhyrë në disa prej të drejtave themelore të kërkuesve dhe në kushtet kur ata (kërkuesit) janë persona të tretë në procedimin penal është e vështirë që pasojat e ndërhyrjes në të drejtat kushtetuese të tyre të riparohen gjatë procesit të themelit, që do të vendosë për faktin penal dhe (pa) fajësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.**

## ***Eljona Hoxha, Flamur Hoxha, Teuta Hoxha, Brunilda Mene - vendimi nr. 279, datë 19.11.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve***

### *Faktet*

Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal për të cilin ka marrë në cilësinë e personit të dyshuar një ish deputet, për disa vepra penale, si shpërdorimi i detyrës, korrupsioni pasiv, mosdeklarim i pasurisë dhe pastrimit të produkteve të veprës penale. Mbi bazën e kërkesës së prokurorisë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka lejuar kontrollin personal ndaj disa personave (të afërm me personin e dyshuar) dhe kontrollin e disa vendeve, me qëllim gjetjen dhe sekuestrimin e provave materiale që lidheshin me veprat penale për të cilat kishte filluar hetimi. Kërkuesit me pretendimin se gjatë kontrollit u janë sekuestruar disa sende që ishin për përdorim vetjak, familjar dhe të përditshëm, dhe që nuk përbënin prova materiale që lidheshin me veprat penale që po hetoheshin kanë paraqitur ankim në gjykatë për heqjen e masës së sekuestros. Të dyja gjykatat e faktit nuk e kanë pranuar ankimin e kërkuesve. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë nuk ka pranuar rekursin e tyre si të pabazuar në ligj. Kërkuesit iu drejtuan Gjykatës me kërkesës për shfuqizimin e të tria vendimeve gjyqësore.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*Legjitimi ratione materiae* - Kur pretendohet shkelja e të drejtave kushtetuese përgjatë procedimit penal, ankuesi duhet të deklarojë faktet në mënyrë specifike, të saktë dhe të plotë, në mënyrë që të krijohet mundësia e vlerësimit nëse ekziston ose jo një gabim procedural me pasoja kushtetuese. Kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë të dhënë që të krijojë ndonjë dyshim se gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes mund të keqpërdoren të dhënat dhe komunikimet e jetës private të tyre, në kushtet kur legjislacioni procedural penal ofron garancitë e duhura në këtë drejtim. Gjykatat i kanë konsideruar sendet e sekuestruara me vlerë provuese për faktet e procedimit penal dhe të dhënat në to, të llojit dokument. Kjo do të thotë se ka një parashikim ligjor që lejon ndërhyrjen eventuale në komunikimet dhe korrespondencën elektronike të kërkuesve dhe është e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal. Në ankimin kushtetues individual nuk është parashtruar saktësisht se sa ka zgatur në kohë veprimtaria e sekuestrimit të sendit, ndaj pretendimi se për kryerjen e këtij veprimi procedural një prej kërkuesve i është hequr liria personale është haptazi i pabazuar. Kufizimi i disponimit të lirë të sendeve të sekuestruara ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe për to është ndjekur rregullisht procedura ligjore. Prokuroria dhe gjykatat kanë dhënë argumente të mjaftueshme dhe bindëse se për se janë sekuestruar sendet, një pjesë e të cilave pas përfundimit të aktit të ekspertimit do t'u kthehen pronarëve të tyre, ndërsa për pjesën tjetër do t'u verifikohet burimi i krijimit, në kushtet kur vepra penale objekt hetimi është ajo e pastrimit të produkteve të veprës penale.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**E drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur — Standardi i arsytimit të vendimit**

## **FJALË KYÇE**

**Status i nëpunësit civil / urdhër për kalimin në listëpritje / njoftim i Gjykatës së Lartë / interpretim arbitrar**

**Mungesa e njoftimit individual nga Gjykata e Lartë për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk cenon të drejtën për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.**

**Interpretimi i Gjykatës së Lartë për mosmarrëveshjen konkrete nuk rezulton të jetë arbitrar apo i paarsyshëm, por ajo ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues.**

## ***Migena Reçi – vendimi nr. 282, datë 25.11.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve***

### *Faktet*

Kërkuësja ka punuar në një institucion shtetëror dhe në datën 19.12.2013 është miratuar kalimi i saj në listëpritje në kuadër të ristrukturimit të institucionit. Kërkuësja iu drejtua gjykatave me padi për kundërshtimin e urdhrit të kalimit në listëpritje. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi pranimin pjesërisht të padisë me arsytimin se ndaj kërkuëses zbatohet ligji për statusin e nëpunësit civil nr. 8549/1999. Gjykata e Apelit vendosi pranimin pjesërisht të padisë me arsytimin se ligji i zbatueshëm ishte ai nr. 152/2013. Gjykata e Lartë ndryshimin e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë. Sipas saj ligji i zbatueshëm ishte ligji nr. 8549/1999, por kalimi në listëpritje nuk është absolutisht i pavlefshëm.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*E drejta për t'u njoftuar e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur* - Mungesa e njoftimit individual nga Gjykata e Lartë për datën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit nuk rezulton të ketë ndikuar në cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur të kërkuëses, në kuptimin substancial, për sa kohë që ajo është njoftuar për rekursin, dhe ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs. Në rekurse janë ngritur pretendime të cilat janë debatuar nga palët.

*Standardi i arsytimit të vendimit* – Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se Gjykata e Lartë ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit të zbatueshëm në mosmarrëveshjen konkrete, duke arsyetuar se ligji i zbatueshëm është ai nr. 8549/1999. Pretendimet e kërkuëses janë me natyrë ligjore dhe lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë kundërbërje dhe të mos ketë respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe nuk rezulton që interpretimi i ligjit të ketë qenë arbitrar.

### *Vendimarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (një gjyqtare u shpreh me mendim pakice)

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**E drejta e aksesit dhe e ankimit substancial – e drejta për t'u dëgjuar në aspekt të arsytimit të vendimit gjyqësor**

## **FJALË KYÇE**

**Kontratë huaje noteriale/  
Kallëzim penal/ vendim  
mosfillimi procedimi penal/  
padi civile për zgjidhje  
konflikti**

**Efkti ligjor i vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi është mosushtrimi i ndjekjes penale për faktin e kallëzuar prej tij në raport me të dhënat e disponuara dhe situatën faktike në momentin në të cilin ai vendim është marrë. Këto vendime nuk kanë sjellë dhe as mund të sillnin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës, të cilën kërkuesi ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike ta mbrojë përmes një padie civile, duke iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konfliktit. Në rastin e një vendimi në favor të tij, mjete i përdorur nga kërkuesi nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes së të drejtës substancialë, për sa kohë që ai nuk është i tillë që mund të rivendosë të drejtën e pretenduar të cenuar.**

## **Thodhori Stambollaj - vendimi nr. 283, datë 25.11.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve**

### *Faktet*

Kërkuesi ka lidhur një kontratë huaje me dy shtetas të tjerë duke u dhënë një hua në vlerën 6 000 000 lekë me afat të përcaktuar për kthimin e saj. Për garantimin e detyrimit për kthimin e huasë, në të njëjtën datë, është lidhur edhe një kontratë hipotekimi, sipas së cilës huamarrësit kanë vendosur në hipotekë, në favor të kërkuesit, një pasuri të tyre. Pas 9 vitesh kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal për veprën penale “Mashtrimi” ndaj huamarrësve. Prokuroria e Korçës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pasi fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, por mund të zgjidhet me padi civile për zgjidhjen e konfliktit. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të kundërshtuar vendimin e prokurorit e cila vendosi rrëzimin e kërkesëpadiës. Mbi ankimin e kërkuesit gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë. Pas marrjes dijëni se pasuria e lënë si garanci për shlyerjen e huasë i është shitur një personi të tretë, kërkuesi ka bërë sërish kallëzim penal. Pas vendimit të mosfillimit të procedimit penal nga prokurori, kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës. Mbi ankimin e kërkuesit gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Ndërkohë Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e apelit duke kthyer çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë. Në rigjykim, gjykata e apelit ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Gjykata e Lartë pas rekursit të kërkuesit ka vendosur mospranimin e tij.

Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e tre vendimeve të gjykatave.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*Legjitimi ratione personae* -Për sa i përket aspektit substancial të këtij kriteri, Mbledhja e Gjyqtarëve do të ndalet në verifikimin e së drejtës kushtetuese që vihet në diskutim dhe, më tej, në drejtim të pasojave që i kanë ardhur kërkuesit në atë të drejtë, në kuptim të justifikimit prej tij të statusit të viktimës. Pretendimet e kërkuesit janë fokusuar në aspektet procedurale të procesit të kundërshtuar, pa arritur të evidentojë të drejtën kushtetuese me natyrë substancialë që kërkon të mbrojë përmes ushtrimit të së drejtës kushtetuese me natyrë procedurale, asaj për proces të rregullt. Megjithatë, duke pasur parasysh marrëdhënien mes palëve (huadhënësit/kërkuesit dhe huamarrësve/të kallëzuarve), edhe nëse do të konsiderohej se qëllimi i kërkuesit është kthimi i shumës së dhënë hua, që përfshihet në konceptin e pasurisë, pra mbrohet nga e drejta e pronës private, kërkuesi nuk e ka argumentuar cenimin e kësaj të drejte për shkak të vendimmarrjes së kundërshtuar. Efkti ligjor i vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesi është mosushtrimi i ndjekjes penale për faktin e kallëzuar prej tij në raport me të dhënat e disponuara dhe situatën faktike në momentin në të cilin ai vendim është marrë. Këto vendime nuk kanë sjellë dhe as mund të sillnin ndonjë pasojë në të drejtën e pronës së kërkuesit, të cilën ai ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike ta mbrojë përmes një padie civile, duke iu drejtuar gjykatës për zgjidhjen e konfliktit. Në rastin e një vendimi në favor të tij, mjete i përdorur nga kërkuesi nuk provohet se do të ofronte një perspektivë suksesi në drejtim të mbrojtjes së të drejtës substancialë, për sa kohë që ai nuk është i tillë që mund të rivendosë të drejtën e pretenduar të cenuar.

Ky kriter është i ndërlidhur edhe me kriterin e shterimit të mjeteve juridike, për sa kohë që kërkuesi jo vetëm që nuk ka provuar se mjetet juridike të përdorura prej tij (kallëzimi penal dhe ankimi ndaj vendimeve të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal) ishin mjetet e vetme në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës së pretenduar të cenuar dhe se ai nuk ka asnjë mjet tjetër në dispozicion apo se mjetet e tjera, siç është edhe e drejta për të vënë në lëvizje procesin gjyqësor civil, nuk do të ishin efektive në aspektin kushtetues, pra se nga pikëpamja e efektivitetit nuk mund të riparohet të drejtën e cenuar.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskallimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.



# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**E drejta për t'u zgjedhur dhe parimi i proporcionalitetit - Parimi i barazisë përpara ligjit — E drejta e aksesit— Parimi i gjykatës së caktuar me ligj — E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme - Standardi i arsytimit të vendimit**

## **FJALË KYÇE**

**Shkresë e drejtorit të burgjeve / masë sigurimi / kandidat për kryetar të bashkisë / e drejta për t'u betuar**

**Kufizimi që është vendosur ndaj kërkuesit në ushtrimin e së drejtës për t'u betuar është rrjedhojë e zbatimit të një mase sigurimi personal. Ky kufizim nuk është rezultat i shkresës së drejtorit të përgjithshëm të burgjeve që i ka refuzuar kërkuesit dhënien e lejes së veçantë për të bërë betimin si kryetar i zgjedhur i Bashkisë.**

## **Dhionisios Alfred Beleri – vendimi nr. 300, datë 16.12.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve**

### *Faktet*

Kërkuesi ka qenë kandidat për kryetar bashkie. Dy ditë përpara zgjedhjeve ai është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje. Me vendim të KQZ ai është shpallur fitues. Me kërkesën e prokurorisë, gjykatat kanë caktuar masën e sigurimit arresti në burg. Kërkuesi ka paraqitur kërkesë për marrjen e lejes së veçantë për t'u paraqitur dhe për të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak për të kryer betimin si kryetar. Me anë të një shkrese, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka refuzuar kërkesën e tij. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës për të kundërshtuar aktin – shkresë, të cilat kanë vendosur rrezimin e kërkesës, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

Mbledhja e Gjyqtarëve konstatoi se kufizimi që është vendosur ndaj kërkuesit në ushtrimin e së drejtës për t'u betuar është i ndërlidhur me ekzistencën e një vepre penale për të cilën ndaj tij ishte vendosur masa e sigurimit personal dhe për të cilën, në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, ai po gjykohej ende nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në thelb, ky kufizim është rrjedhojë e zbatimit të një mase sigurimi personal të vendosur nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe jo i shkresës së drejtorit të përgjithshëm të burgjeve që i ka refuzuar kërkuesit dhënien e lejes së veçantë për të bërë betimin si kryetar i zgjedhur i bashkisë.

### *Vendimarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pakice)



# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

## Legjitimimi *ratione personae*

### FJALË KYÇE

Ankim / detyrim tatimor / kallëzim penal / ekspertë / gjyqtarë / prokurorë

**Pretendimet e kërkuesses janë fokusuar tek antikushtetutshmëria e vendimeve gjyqësore në proceset penale të cilat ajo i ka vënë në lëvizje pasi ka humbur me vendim gjyqësor përfundimtar të drejtën e pretenduar për anulimin e detyrimeve tatimore të vendosura në ngarkim të saj nga organet tatimore. Kërkuessa nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi rivendosja e së drejtës së pronës private që pretendohet se është cenuar, në rastin konkret, nuk duket se varet nga mënyra e përfundimit të proceseve penale të kontestuara.**

## Leonora Puro - vendimi nr. 307, datë 16.12.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve

### Faktet

Kërkuessa ka rezultuar humbëse në procesin gjyqësor administrativ që kishte për objekt ligjshmërinë e detyrimeve tatimore që i ishin ngarkuar asaj. Ai proces është mbyllur me vendim pushimi nga Gjykata e Lartë. Për kallëzimin e saj ndaj punonjëseve tatimore që i kanë ngarkuar detyrimin tatimor, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit, që i dënonin ato, dhe pushimin e çështjes penale, me argumentin se legjislacioni tatimor në momentin ushtrimi të kontrollit pranë subjektit tatimor nuk parashikonte shprehimisht detyrimin e blerësit për të nënshkruar faturat tatimore, ndaj mosevidentimi si shkelje nga ana e të pandehurave për këtë shkak nuk konsiderohej mospërbushje e detyrës së tyre funksionale. Në lidhje me këto procese, kërkuessa ka paraqitur 2 kallëzime penale, një ndaj ekspertëve të thirrur në gjykim dhe një ndaj gjyqtarëve e prokurorëve që kanë gjykuar çështjen dhe disa ekspertëve të tjerë. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit për kallëzimin e kërkuesses ndaj ekspertëve, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, ndërsa për kallëzimin penal ndaj gjyqtarëve, prokurorëve e ekspertëve të tjerë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak të mosfirmosjes së tij nga mbrojtësi, pavarësisht se kërkuessa ishte bërë me dije për këtë detyrim ligjor.

### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

*Legjitimi ratione personae* -Pretendimet e kërkuesses janë fokusuar tek antikushtetutshmëria e vendimeve gjyqësore në proceset penale të cilat ajo i ka vënë në lëvizje pasi ka humbur me vendim gjyqësor përfundimtar të drejtën e pretenduar për anulimin e detyrimeve tatimore të vendosura në ngarkim të saj nga organet tatimore. Kërkuessa nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi rivendosja e së drejtës së pronës private që pretendohet se është cenuar, në rastin konkret, nuk duket se varet nga mënyra e përfundimit të proceseve penale të kontestuara.

### Vendimmarrja

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.